



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



# DORACAKU I TRAJNERËVE

Punimet artizanale të thuprës

**2016.2094.7-004.00**

Ky program kursi u mundësua nga Shoqata "Together for Life", në kuadrin e programit 'Sustainable Economic and regional development, employment promotion and Vocational Education and Training – ProSEED', me mbështetjen e GIZ.

### I. Parathënie

#### a) Sfondi

Shkalla e papunësisë në Shqipëri ka rënë nën nivelin e 12% gjatë vitit 2019, megjithatë papunësia tek të rinjtë mbetet në nivele të larta, rreth 2 herë më të larta nga papunësia mesatare në shkallë vendi. Krahasuar me pjesën tjetër të popullsisë, shkalla e papunësisë për pakicat është rreth 4 herë më e lartë. Mungesa e punësimit dhe kushtet e këqija ekonomike e bëjnë këtë komunitet kontigjentin kryesor për të lënë Shqipërinë në kërkim të një jete më të mirë në vendet e Bashkimit Evropian.

Të dhënat nga organizatat romë dhe egjiptiane që punojnë në rrethet e Korçës dhe Ebasan tregojnë se numri i personave që largohen nga Shqipëria po rritet, duke dhënë si arsye kryesore: mungesën e punësimit dhe kushtet e rënda ekonomike në të cilat ata jetojnë.

Shkalla e punësimit në Programet e Nxitjes së Punësimit për komunitetin Rom dhe Egjiptian është 3% për 2017 dhe 4% për 2018, ndërkohë niveli i punësimit për pjesën tjetër të popullsinë është 6.5% për 2017 dhe 2018.

Projekti “Punimet artizanale të thuprës, shpresa për punësimin e të rinjve romë dhe egjiptianë” mbështetur nga GIZ dhe zbatuar nga Shoqata “Togethet for Life” synon të mbështeti 30 të rinj romë dhe egjiptianë që të fitojnë një profesion në fushën e artizanatit, specifikisht në prodhimin e produkteve të thuprës, dhe t’i mbështetës në gjetjen e tregjeve për shitjen e këtyre produkteve. Kjo qëllim i projektit pritet të realizohet nëpërmjet vendosjes së bashkëpunimit ndërmjet bizneseve lokale, Zyrës së Punës, strukturave të qeverisjes vendore dhe projekteve përkatëse të GIZ dhe partnerëve të saj për identifikimin e referimeve dhe ofrimin e masave mbështetëse.

Gjatë realizimit të aktiviteteve, projekti do të përgatisë **Programin e Unifikuar të Kursit: Punimet prej Thupre.**

#### b) Rreth doracakut

Misioni i këtij Doracaku është që të ofrojë udhëzime për trajnerët në mënyrë që ata të zbatojnë aktivitetet e këtij programi trajnimi, si dhe të kuptojnë filozofinë e tij.

Doracaku do t’i shërbejë qëllimeve të mëposhtme:

- Do të veprojë si një prezantim i materialit mësimor që do të jetë objekt i projektit të trajnimit profesional –Prodhimi i Produkteve prej Thupre
- Do të transferojë konceptin e programit për të gjitha palët e interesuara.
- Do të përcaktojë strukturën e trajnimit profesional.

### c) Si ta përdorim Doracakun

Doracaku shërben si udhëzues për trajnerët. Doracaku duhet të konsiderohet si ndihmë për trajnerin, pasi ofron një analizë të plotë të moduleve dhe strukturës së tyre. Së dyti, ky material thekson se çfarë parashikohet nga trajnerët në aspektin e mjeteve të trajnimit dhe rezultateve të dëshiruara të të nxënit.

Pra, Doracaku duhet të përdoret nga trajnerët si një formë ndihme dhe sqarimesh përgjatë gjithë procesit të mësimdhënies.

Ju si trajner duhet të merrni parasysh përvojën individuale të të mësuarit dhe aftësitë e të trajnuarve tuaj, në mënyrë që të vlerësoni raportin midis mësimit teorik dhe praktik.

Si moment kyç në punën tuaj si trajner ju mund të përdorni:

- Zhvillimin e qëllimeve dhe objektivave të drejtuara nga personi;
- Kryerjen e një kursi trajnimi që përputhet me këto qëllime dhe objektiva;
- Organizimin e trajnimeve, duke marrë parasysh përvojën dhe aftësitë e nxënësve;
- Përzgjedhjen e një metode të përshtatshme mësimore që promovon angazhimin e nxënësve të AFP-së;
- Shqyrtimin e progresit të tyre;

Rishikimin periodik të bilancit dhe sekuencave ndërmjet llojeve të ndryshme të aktiviteteve - seancave teorike dhe seancave praktike.

## II. Përgatitja e Trajnimit

### a) Qëllimet e trajnimit

**Qëllimet e programit të trajnimit AFP janë:**

- Identifikimi dhe përdorimi i aftësive, njohurive, pasionit, talenteve të nxënësve që ndjekin kursin e formimit profesional në krijim e produkteve cilësore prej thupre;
- Vendosja në dispozicion e të gjitha burimeve për përdorim produktiv - duke mundësuar rritjen e të ardhurave dhe uljen e papunësisë së të rinjve.

### **Grupet e synuara si nxënës mund të jenë:**

- Nxënësit që ndjekin kurset e formimit profesional (klasa 10, 11, 12);
- Të rinjtë e interesuar për t'u bërë mjeshtra të prodhimit të produkteve prej thupre;
- Të rinjtë e papunë, të cilët janë të motivuar për të ngritur një ndërmarrje artistike;
- Personat edisavantazhuar në tregun e punës.

### **b) Parimet udhëzuese**

Metodat e trajnimit të përdorura nga trajnerët dhe lehtësuesit e trajnimit duhet të sigurojnë që pjesëmarrësit të jenë të qetë, të vendosin objektivat e të mësuarit sipas plan-programit të paracaktuar dhe pastaj t'i përfshijnë të trajnuarit në ciklin e të nxënësit eksperimental. Kjo i lejon nxënësit e AFP-së të njihet me një përvojë, të reflektojnë mbi të dhe të jetë vetë nxënësi që të nxjerrë konkluzione dhe të vendosë se si ta zbatojë atë në përvojën personale.

Nxënësit mund dhe duhet të mësojnë nga instruktori dhe nga nxënësit e tjerë, nëse ata sjellin eksperiencat personale apo të familjes në teknikat e punimit të thuprës.

Ju si trajner / lehtësues i AFP gjatë seancave të trajnimit në klasë duhet të përdorni një sërë metodash trajnimit si:

- Ndërthurje e informacionit teorik dhe punës praktike rreth mbledhjes dhe përpunimit të lëndës së parë
- Ndërthurje e informacionit teorik dhe punës praktike rreth punimit të thuprës;
- Ndërthurje e informacionit teorik dhe punës praktike për prodhimin e shportës tradicionale;
- Informacion teorik rreth ngritjes së një biznesit artizanal;
- Informacion teorik rreth organizmit të fushatave për marketimin e produktit;
- Ushtrime argëtuese

Mos harroni se gjatë trajnimit duhet të përdorni teknika stimuluese me qëllim për të mbajtur lart vëmendjen dhe gjendjen shpirtërore të nxënësve.

### **Mos harroni këto këshilla:**

- Jini SMART (fizikisht dhe mendërisht);
- Jini të ndjeshëm ndaj nevojave të studentëve dhe jini në dispozicion të kërkesave të tyre;
- Dëgjoni pyetjet e studentëve dhe adresojini ato;

- Nëse mendoni se disa studentë nuk po ju kuptojnë, ju lutem, përpiquni të jepni sqarime;
- Flisni PAK, lejoni pjesëmarrësit të flasin MË SHUMË;

### c) Vlerësimi

Kursantët vlerësohen nga instruktorët e Kursit për të gjitha Rezultatet Mësimore që përmbajnë të gjitha Modulet e Kursit dhe nëse vlerësohen pozitivisht, futen në Provimin përfundimtar teoriko-praktik.

Nëse vlerësohen pozitivisht edhe në Provimin përfundimtar teoriko-praktik, kursantët fitojnë Çertifikatën përkatëse që njihet nga MFE.

### d) Profili i trajnerëve (njohuritë e nevojshme, shkathtësitë dhe kompetencat)

Në kuadër të kursit të formimit profesional '**Punimet prej Thupre**', trajnerët / lehtësuesit duhet të kenë:

- Arsimit të mesëm dhe/ ose profesional për përpunimin e thuprës;
- Eksperiencë në mbi 5 vjet në punimin e thuprës;
- Qendrim pozitiv ndaj të rinjve dhe respektim të nevojave të tyre;
- Komunikim të mirë dhe aftësi dëgjimi aktiv;
- Aftësi të mira shoqërore dhe ndërpersonale;
- Aftësi për të përshtatur trajnimin kur marrin pjesënxënës me aftësi të kufizuara.
- Aftësi të mirë-zhvilluara për të lehtësuar aktivitetet në klasë.
- Një pasion për trajnim të vazhdueshëm.

### e) Burimet e nevojshme

- **Mjetet dhe Pajisjet:** Trajnuesi / lehtësuesi është përgjegjës për t'u siguruar që të ketë gjithçka të nevojshme për funksionimin e qetë të sesionit të trajnimit. Moderatorin do të duhet të përgatisë listën e tij të kontrollit.

Një listë e thjeshtë mund të përfshijë:

- Axhendën;
- Programin ditor;
- Lëndë të parë të mjaftueshme për prodhimin e produkteve të thuprës;
  - Mjetet e nevojshme si: thika, brisqe, gërsërë hortikulture, gjilpëra, pinca për lakimin e thuprave të shelgut, kallëpe modeli të formave dhe përmasave të ndryshme, skica modelesh

- Listën e pjesëmarrësve
  - Formularin e pritshmërive
- **Sistemimi i ambientit të trajnimit:** Sigurohuni që të keni zgjedhur një mjedis të përshtatshëm trajnimi që do të mundësojë kryerjen e suksesshme të seancave të trajnimit me hapësirat e nevojshme për punë artizanale dhe të pajisur me tryeza të posaçme pune.

Ju mund të merrni në konsideratësa më poshtë:

- Qëmjetet dhe pajisjet janë të gjitha gati;
- Pjesëmarrësve u është siguruar uji i pijshëm;
- Që tavolinat dhe karriget janë vendosur në formën dhe mënyrën e duhur për tëpunuar në mënyrë sa më komode dheqë lektori ka fushëpamje të mirë tek i gjithë auditori dhe mundësi për të lëvizuar lirshëm nga njëri nxënës tek tjetri;
- Që ndriçimi dhe temperatura e ambientit janë në nivelet e duhura;
- Që pjesëmarrësit të kenë mundësi të bashkëveprojnë me njëri-tjetrin në mënyrë që të rrisin aftësitë e tyre dhe të zhvillojnëaftësitë.

Nëse keni student me aftësi të kufizuara në sallë, ju lutem bëni kujdes që të siguroheni se:

- Salla e trajnimit dhe rruga për tek vendi ku ai do të qëndrojë është i përshtatshëm / i arritshëm për aftësitë e tij fizike apo shqisore;
- Ambientiështë i përshtatur me rapma dhe pajisje të tjera për nxënësit paratetraplegjikë (në karrocë);
- Ekziston një vend i përshtatshëm për shoqëruesin që mund të ndihmojë nxënësin me aftësi të kufizuara.

- **Vendosni klimën e duhur për grupin**

Në sesionin tuaj të parë si trajner osesi lehtësues i kursit mundësojini pjesëmarrësve të prezantohen për klasën, si hapi i parë i prezantimit dhe njohjes me njëri-tjetrit.Pjesëmarrësit do të prezantohen duke dhënë informacion bazë rreth eksperiencës personale profesionale dhe/ ose sipërmarrëse shkurt dhe qartë, në mënyrë që profili i tij të jetë e lehtë të mbahet mend nga të pranishmit.

Në seancën e parë të trajnimit mësuesi duhet të:

- Prezantojë qëllimin, objektivat dhe aktivitetet e trajnimit në vazhdim;
- Mbledhë pritshmëritë e pjesëmarrësve, duke i kërkuar secilit të plotësojë formularë të përgatitur prarapakisht prej jush;
- Adresoni shqetësimet e nxënësve;
- Krijojë një listë të rregullave dhe normave bazë që duhen respektuar gjatë seancave të trajnimit, me miratimin e nxënësve;
- Harmonizojë objektivat me pritshmëritë dhe frikërat e nxënësve.
- Sigurohuni që të gjithë pjesëmarrësit janë shprehur rreth pritshmërive, shqetësimeve dhe rregullave bazë.

### III. Paraqitja e Trajnimit

#### III.1 TEMA 1:

#### **SHPORTARIA, MJESHTËRIA E PRODHIMIT TË PRODUKTEVE PREJ THUPRE**

Numri i Modullit & Titulli	1. Shportaria, mjeshtëria e prodhimit të produkteve prej thupre
Përshkrimi	Qëllimi i këtij leksioni është të prezantojë elementët kryesorë të prodhimit të produkteve prej thupre. Nxënësit e përfshirë në këtë kurs do të jenë në gjendje të identifikojnë lëndën e parë për prodhimin e shportave. Pas përfundimit të kursit ata do të dinë ta trajtojnë lëndën e parë dhe ta përgatisin për punë dhe do të jenë në gjendje të thurin një shportë klasike nga fillimi në fund.
Qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të arrini t'i bëni nxënësit të kuptojnë dallimet, cilësitë dhe vlerat e xunkthit, shelgut dhe kashtës;</li> <li>• T'u mësoni nxënësve të mbledhin, përgatisin dhe ruajnë lëndën e parë në kushte të përshtatshme</li> <li>• T'u mësoni nxënësve të përzgjedhin thuprat me cilësitë dhe të dhënat teknike të përshtatshme për pjesë të caktuara të shportës;</li> <li>• T'u mësoni nxënësve të endin dhe thurin bazën e shportës sa më cilësore dhe estetike;</li> <li>• T'u mësoni nxënësve të thurin muret anësore të shportës;</li> <li>• T'u mësoni nxënësve të thurin buzët e shportës;</li> <li>• T'u mësoni nxënësve të përgatisin dorezën / dorezat e shportës;</li> <li>• T'u mësoni nxënësve të përgatisin kapakun e shportës;</li> <li>• T'u mësoni nxënësve teknika të ndryshme që përdoren për prodhimin e shportave dhe produkteve të tjera prej thupre;</li> <li>• Të nxisni kreativitetin e nxënësve për dizenjimin dhe realizmin e produkteve të reja dhe innovative prej thupre.</li> </ul>
Materiale Trajnuese	Thika, brisqe, gërsërë hortikulture, gjilpëra, pinca për lakimin e thuprave të shelgut, vaskë për regjien e thuprave, tryeza të posaçme pune, kallëpe modeli të formave dhe përmasave të ndryshme, skica modelesh, produkte të ndryshme prej thopre që shërbejnë si modele.
Kohëzgjatja	50 orë mësimore (1 orë mësimore = 45 minuta) Rekomandohet 90% praktikë, 5% teori dhe 5% vlerësime
Rezultatet e mësimimit (Kompetencat e	Pas përfundimit të kësaj pjese të kursit, nxënësi të jetë i aftë që vetë të dizenjojë dhe të prodhojë një produkt prej thupre



## Doracaku për trajnerët

arritshme)

<b>Etapat</b>	<b>Aktiviteti i trainerit</b>	<b>Aktiviteti i të trajnuarit</b>	<b>Materiale trajnuese</b>	<b>Kohë-zgjatja</b>
<b>1.Lidhja e temës me tema të mëparshme</b>	-	-	-	-
<b>2. Tema e Modulit:</b> Shportaria, mjeshtëria e prodhimit të produkteve prej thupre				
<b>2.1 Pse një kurs shportarie?</b>	<u>Metoda e 'perceptimit':</u> Prezantimi me gojë i përkufizimit me një shembull.	Të kuptojnë idenë themelore të shportarisë	Slide	15 minuta
<b>2.2 Procesi i Prodhimit të shportave prej thupre</b>	<u>Metoda e 'perceptimi':</u> Ilustrim praktik i procesit të thurjes së shportës	Të kuptojnë idenë themelore teknikës së thurjes dhe të fitojnë aftësi në thurjen e shportës	Fije thupre të gjatësive dhe diametrave të ndryshëm	30 minuta
<b>2.3 Mjetet e nevojshme për prodhimin e produkteve të thuprës</b>	<u>Metoda e 'perceptimit':</u> Demonstrim praktik i mjeteteve dhe funksionit të tyre	Të njohin mjetet që nevojiten për prodhimin e produkteve të kashtës dhe përdorimin e tyre në çdo proces	Gërshërë, pinca, thikë, etj.	15 min
<b>2.4 Lënda e parë, thuprat</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Xunkthi</li> <li>• Shelgu</li> </ul>	<u>Metoda e 'perceptimit':</u> Prezantimi me gojë i cilësive të	Të përshkruajë cilësitë e produkteve që shërbejnë si lëndë e parë, t'i njohë dhe	Fije xuknthi, shelgu dhe kashe	30 minuta

## Doracaku për trajnerët

<ul style="list-style-type: none"> <li>Kashta</li> </ul>	<p>produkteve që shërbejnë si lëndë e parë për thurjen e shportave dhe ilustrimi praktik duke prezantuar konkretisht llojet e thuprave që rriten në Shqipëri</p>	<p>identifikojë xunkthin, shelgun dhe kashtën në praktikë</p>			
<p><b>2.5 Korrja e thuprës</b></p>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> Demonstrim praktik i mbledhjes/ korrjes së thuprës në natyrë</p>	<p>Të mësojë praktikisht se si të mbledhi thuprën</p>	<p>Gërshërë horticulture , thikë</p>	<p>3 orë</p>	
<p><b>2.6 Përgatitja e lëndës së parë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li><u>Ruajtja e thuprës</u></li> </ul>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> Demonstrim praktik se si duhet të trajtohet thupra para procesit të punës dhe kushtet e ruajtjes së saj</p>	<p>Të mësojë praktikisht se si të trajtojë thuprën dhe të jetë I vetëdijshëm për rëndësinë e respektimit të kushteve të ruajtjes së thuprës</p>	<p>Thikë, tigan, vaskë</p>	<p>45 minuta</p>	
<p><b>2.7 Përcaktimi i dizajnit të produktit</b></p>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> prezantim me ilustrime fotografike, skica dhe me objekte thupre</p>	<p>Nxënësit bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e dizajnit në prodhimin e produkteve të</p>	<p>Slide, produkte thupre.</p>	<p>2 orë</p>	

## Doracaku për trajnerët

		thuprës.		
<b>2.8 Prodhimi i shportës</b> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Thurja e fundit të shportës</li> <li>• Thurja e anëve/ mureve të shportës</li> <li>• Thurja e dorezës</li> <li>• Thurja e kapakut</li> </ul>	<u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> sqarim, këshillim me gojë, demonstrim praktik i procesit të thurjes së të gjithë pjesëve të shportës, tutorim teorik dhe praktik i nxënësit gjatë gjithë procesit të prodhimit të shportës klasike	Nxënësit janë të aftë të: -përzgjedhin thuprën sipas cilësive dhe përmasave për secilën prej pjesëve të shportës; - bëjnë organizimin e vogël të punës për prodhimin e një shporte tradicionale; - përgatisin vendin, veglat dhe materialet për punë. - punojnë në mënyrë të pavaruara për prodhimin e secilës pjesë të shportës tradicionale. - mirëmbajnë veglat, lëndën e parë dhe sistemojnë vendin e punës mbas përfundimit të orës mësimore.	Fije thupre të gjatësive dhe diametrave të ndryshëm, kallupa për modelin, thika, pinca, ujë, furçe	30 orë mësimi
<b>2.9 Njohja me produkte të tjera të prodhuara nga thupra</b>	<u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> Prezantim me gojë i produkteve nëpërmjet pamjeve	Nxënësi është i aftë të kuptojë teknikat e thurjes së aplikuara nga produktet që shfaqen në slite dhe të jetë në gjendje të realizojë disa prej tyre	Slite	45 min

## Doracaku për trajnerët

<p><b>2.10 Prodhimi i produkteve të reja</b></p>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’</u>:U sugjeron nxënësve të përzgjedhin një product të ri për ta realizuar në mënyrë të pavaruar. Mësuesi mbikqyr punën e nxënësit gjatë gjithë procesit të prodhimit</p>	<p>Nxënësi është i aftë të: - skicojë një produkt të ri; Ta realizojë vetë të gjithë procesin, që nga zgjedhja e lëndës së parë, deri tek produkti përfundimtar</p>	<p>Fije thupre të gjatësive dhe diametrave të ndryshëm, thika, pinca, ujë, furçe</p>	<p>10 orë</p>
<p><b>2.11 Kontrolli i cilësisë</b></p>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’</u>: Prezantim me gojë i përkufizimit të kontrollit të cilësisë dhe rëndësisë së tij</p>	<p>Të kuptojnë rëndësinë e kontrollit të cilësisë</p>	<p>Slide</p>	<p>10 minuta</p>
<p><b>2.12 Transporti dhe Magazinimi</b></p>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’</u>: Prezantim me gojë i rëndësisë së transportit dhe magazinimit të produkteve</p>	<p>Të kuptojnë rëndësisën e marrjes së masave për transport dhe magazinim të sigurt</p>	<p>Slide</p>	<p>10 min</p>
<p><b>2.13 E ardhmja</b></p>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’</u>: Nxit diskutimin e mjesëmarrësve për të ardhmen e profesionit të shportarisë</p>	<p>Nëpërmjet diskutimit të kuptojnë qëndësinë e pajises me një profesiona që I takon sa të shkuarës, aq edhe të ardhmes.</p>	<p>Slide</p>	<p>10 min</p>

## Doracaku për trajnerët

<b>3. Përmbledhje</b>	<u>Metoda e ‘të bërit të vetëdijshëm’:</u> <u>Prezantimi i një filmi të shkurtër.</u>	Studentët shohin filmin.	Film dhe multimedia	5 minuta
<b>4. Diskutime &amp; Reagime</b>	Mësuesi u kërkon nxënësve të shkruajnë nëse u përmbushën pritshëmrinë nga kjo pjesë e kursit. Diskutohen pritshëmrinë në grup	Studentët plotësojnë formularin e përmbushjes së pritshëmërive	Formularët e pritshëmërisë (letër A4)	10 minuta

Numri i Modullit & Titulli	<b>2. Si të bëhesh sipërmarrës</b>
Përshkrimi	<p>Ky modul ofron bazat e identifikimit të mundësive dhe gjenerimit të idesë duke listuar pesë etapat e saj dhe aspektet kyçe. Së dyti, gjatë ndjekjes së këtij moduli, nxënësi mëson hapat që duhet të ndërmerren për regjistrimin e një sipërmarrjeje në Shqipëri, regjistrimi në strukturat tatimore qendrore dhe vendore. Nxënësi infomohet rreth detyrimeve që lind nga regjistrimi i biznesit. Nxënësi njih format e ndryshme të biznesit dhe është në gjendje të përzgjedh formën më të mirë për regjistrimin e biznesit të tij.</p> <p>Këtu nxënësi merr informacionin bazë rreth menaxhimit dhe drejtimit të qendrueshëm të një sipërmarrjeje dhe rëndësisë së vendimarrjes demokratike në drejtimin e sipërmarrjes.</p>
Qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mësojnë të punojnë me një ide biznesi</li> <li>• Të njohin procedurat dhe dokumentat që nevojiten për hapjen e një biznesi;</li> <li>• Të dinë të përgatisin dokumentat për regjistrimin e një biznesi në QKB</li> <li>• Të njohin procedurat dhe dokumentat që nevojiten regjistrimin e biznesit në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore</li> <li>• Të dinë të përgatisin dokumentat për regjistrimin e biznesit në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore</li> <li>• Të njohin njohin detyrimet fiskale që lindin nga çelja e një biznesi;</li> <li>• Të dinë të llogarisin detyrimet fiskale të biznesit</li> <li>• Të kuptojnë dallimin mes vetëpunësimit dhe biznesit të vogël</li> <li>• Të njohin format e biznesit</li> </ul>
Materiale Didaktike	Slide, pajisje elektronike, film dhe multimedia.
Kohëzgjatja	2 orë

## Doracaku për trajnerët

Rezultatet e Mësimit (Kompetencat e arritshme)	Dizenjimi dhe regjistrimi i një biznesi
---	---

Etapat	Aktiviteti i Trajnerit	Aktiviteti i të Trajnuarit	Materiale Didaktike	Kohëzgjatja, minuta
<b>1.Lidhja e temës me tema të mëparshme</b>	-	-	-	-
<b>2. Tema e Modulit: Si të bëhesh sipërmarrës</b>				
2.1 Punoni mbi një ide	<u>Metoda e ‘perceptimit’</u> : Prezantim me gojë i përkufizimit të idesë nëpërmjet shembujve	Të kuptojnë bazat e identifikimit të mundësive dhe gjenerimit të idesë	Slide	10 minuta
2.2 Regjistrimi i ndërmarjes në QKB dhe QKL <ul style="list-style-type: none"> <li>• Kush mund ta regjistrojë biznesin?</li> <li>• Procedurat dokumentacioni</li> <li>• Regjistrimi</li> </ul>	<u>Metoda e ‘perceptimit’</u> : Prezantim me gojë i hapave që duhet të ndërmerren për regjistrimin e biznesit	Të kuptojnë si të regjistrojnë biznesin në QKB dhe QKL	Slide	35 minuta
2.3 Regjistrimi në strukturat tatimore qendrore dhe vendore	<u>Metoda e ‘perceptimit’</u> : Prezantim me gojë i hapave që duhet të ndërmerren për regjistrimin në strukturat qendrore	Të kuptojnë si të regjistrojnë biznesin në strukturat tatimore qendrore dhe vendore	Slide	25 minuta

## Doracaku për trajnerët

	dhe vendore			
2.4 Format e biznesit	<u>Metoda e ‘perceptimit’</u> : Prezantim me gojë i formave të biznesit	Të kuptojnë cilat janë format e biznesit	Slide	10 minuta
<b>3. Përmbledhje</b>	<u>Metoda e ‘të bërit të vetëdijshëm’</u> : Prezantohet një film i shkurtër	Studentët shikojnë filmin	Film dhe multimedia.	3minuta
<b>4.Diskutime &amp; Reagime</b>	Mësuesi u kërkon nxënësve të përshkruajnë dokumentat dhe proceduart për regjistrimin e biznesit në QKB, QKL dhe strukturat tatimore vendore	Nxënësit përshkruajnë dokumentat dhe proceduart për regjistrimin e biznesit në QKB, QKL dhe strukturat tatimore vendore		7 minuta



**IV.3 Tema Nr. 3:**

**BAZA TË SIPËRMARRJES**

Numri i Modullit & Titulli	<b>3. Baza të Sipërmarrjes</b>
Përshkrimi	Qëllimi i këtij leksioni është të prezantojë elementet kyç që nevojiten për të përgatitur një plan financiar dhe t'i mësojë sipërmarrësve të ardhshëmsi të menaxhojnë më mirë parane, me qëllim ngritjen dhe zhvillimin e një sipërmarrjeje efektive. Fusha e këtij materiali përfshin këshilla për vlerësimin e rrezikut, planifikimin financiar, burimet njerëzore, menaxhimin e kohës, marketingun, mbledhjen e fondeve dhe dokumentet mbështetëse.
Qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të mësojnë se çfarë është plani i biznesit</li> <li>• Të njohin rëndësinë e analizës së tregut dhe vlerësimit të rrezikut;</li> <li>• Të dinë të përgatisin një plan financiar dhe të parashikojnë burimet e mundshme;</li> <li>• Të kuptojnë buxhetin;</li> <li>• Të dinë të llogarisin çminin e produktit / shërbimit;</li> <li>• Të mësojnë rëndësinë e menaxhimit të parave në një sipërmarrje.</li> </ul>
Materiale Didaktike	Slide, pajisje elektronike, film dhe multimedia.
Kohëzgjatja	4 orë Rekomandohet 50% orë teori, 40% orë praktikë dhe 10% orë vlerësime
Rezultatet e Mësimiit (Kompetencat e arritshme)	Hartimi i një plani biznesi të një biznesi të vogël dhe llogaritja e çmimit të produktit

<b>Etapat</b>	<b>Aktiviteti i Trajnerit</b>	<b>Aktiviteti i të Trajnuarit</b>	<b>Materiale Didaktike</b>	<b>Kohëzgjatja, minuta</b>
<b>1.Lidhja e temës me tema të mëparshme</b>	<u>Diskutimi në fillim të seancës për të kujtuar</u>	Ata do të marrin pjesë në diskutim dhe do të rikujtojnë njohuritë kryesore	Nuk nevojiten	5 min

## Doracaku për trajnerët

	<u>njohuritë e përfituara në temën e mëparshme:</u> 2. Si të bëhesh sipërmarrës			
<b>2. Tema e Modulit:</b> <b>Plani i Biznesit</b>				
<b>2.1 Hartimi i planit të biznesit</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Përmbledhja ekzekutive</li><li>• Organizimi dhe menaxhimi</li><li>• Produktet dhe shërbimet e ofruara</li><li>• Marketingu dhe shitja</li></ul>	<u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> Prezantim me gojë i pjesëve të një plani biznesi	Ata bëhen të vetëdijshëm për rëndësinë e planit të biznesit dhe aspektet kryesore të tij	Slides	49 min
<b>2.2. Plani financiar dhe burimet financiare</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Financimi i plan-biznesit</li><li>• Administrimi i parasë</li><li>• Kursimet personale</li><li>• Politikat e çmimit</li></ul>	<u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> Prezantim me gojë i temës duke u ilustruar me shembuj	Të kuptojnë rëndësinë e analizës së tregut dhe përgatisin një plan ndërhyrjesh për shmangien e rreziqeve	Slide	90 min
<b>2.3. Biznesi dhe paratë</b> <ul style="list-style-type: none"><li>• Mbani paratë në bankë</li><li>• Vështirësitë e parasë ‘cash’</li><li>• Financat</li><li>• Zgjuarsia</li></ul>	<u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> Prezantim me gojë dhe analizim i shembujve	Të kuptojnë se çfarë është zgjuarsia financiare dhe sit a përdorin atë	Slides	45 min

## Doracaku për trajnerët

<p>financiare</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlerësimi i shpenzimeve</li> <li>• Vlerësimi i të ardhurave</li> </ul>				
<b>2.4. Skuadra</b>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’</u>: prezantimi me gojë i elementëve të skuadrës</p>	Të kuptojnë rëndësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore	Slide	10 min
<b>2.5. Tregu dhe industria</b>	<p><u>Metoda e ‘perceptimit’</u>: Prezantim me gojë i termave duke dhënë shembuj.</p>	Të kuptojnë dhe të ngrenë strategji për të arritur grupet e synuara	Slide	15 min
<b>2.6 Kalendar</b>	Prezantim me gojë nëpërmjet shembujve.	Të kuptojnë afatin kohor dhe të jenë të aftë të përgatisin një kalendar për biznesin	slite	5 min
<b>2.7 Dokumentacioni mbështetës</b>	Prezantim me gojë nëpërmjet shembujve.	Të kuptojnë dokumentat mbështetës dhe t’i përgatisin ato	slite	5 min
<b>3. Përmbledhje</b>	<p><u>Metoda e ‘të bërit të vetëdijsëm’</u>: Prezantohet një film i shkurtër</p>	Studentët ndjekin filmin	Filmi dhe multimedia.	5 min
<b>4. Diskutime &amp; Reagime</b>	Mësuesi u kërkon	Studentët diskutojnë për një shembull nga		5 min

## Doracaku për trajnerët

	nxënësve të diskutojnë rreth përvojave personale për temën. Mësuesi i përgjigjet çdo pyetjeje individuale.	jeta e tyre rreth praktikave të mira nga përvoja e sipërmarrësve të tjerë.		
--	--	--	--	--

## IV.4 Tema Nr 4:

## FILLIMI, ZHVILLIMI DHE ARRITJA E QËLLIMIT

Numri i Modullit & Titulli	<b>4. Fillimi, zhvillimi dhe arritja e qëllimit</b>
Përshkrimi	Kjo temë ofron informacion mbi elementët bazë për fillimin e një sipërmarrjeje të vogël. Përveç kësaj, këtu përshkruhen strategjitë e rritjes mbi të cilat mbështete një biznes i vogël. Më pas, ndalohet tek përdorimi i mediave për të ngritur një staregji të sukseshme marketing. Rëndësi i jepet marketingut tradicional dhe atijonlinë në ditët e sotme, të përbashkat dhe ndryshimet mes dy llojeve të marketingut.
Qëllimet	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Aftësi për të listuar çështjet që duhet t'i ketë parasysh para se t'i hyjë një sipërmarrjeje;</li> <li>• Kuptimi i hapave që duhet të ndërmerren për rritjen e biznesit;</li> <li>• Të jetë i aftë të kuptojë vlerën e marketingut;</li> <li>• Të jetë i vetëdijshëm për nevojën e krijimit të rrjeteve sociale dhe për përdorimin e mediave sociale për të promovuar vlerën e produkteve artizanale.</li> </ul>
Materiale Didaktike	Slide, pajisje elektronike, film dhe multimedia.
Kohëzgjatja	4 orë Rekomandohet 50% orë teori, 40% orë praktikë dhe 10% orë vlerësime
Rezultatet e Mësimit (Kompetencat e arritshme)	Të vepruarit si një sipërmarrës i suksesshëm në përdorimin e të gjitha burimeve dhe mjeteve në dispozicion

<b>Etapat</b>	<b>Aktiviteti i Trajnerit</b>	<b>Aktiviteti i të Trajnuarit</b>	<b>Materiale Didaktike</b>	<b>Kohëzgjatja, min/orë</b>
<b>1.Lidhja e temës me tema të mëparshme</b>	Rikujton nocionet e mësuara në temën 2 dhe 3	Diskutim	-	5 min
<b>2. Tema e</b>				

## Doracaku për trajnerët

<b>Modulit:</b> <b>Fillimi, zhvillimi dhe arritja e qëllimit</b>				
<b>2.1. Fillimi dhe përgatitja për rritje</b>	<u>Metoda e 'perceptimit'</u> :Prezanti m me gojë i këshillave për një fillim të sukseshëm	Të kuptojnë elementët e rëndësishëm para nisjes së një biznesi	Slides	20 min
<b>2.2. Strategjitë e rritjes së biznesit</b>	<u>Metoda e 'perceptimit'</u> :Prezanti m me gojë i strategjisë për rritje	Ata bëhen të vetëdijshëm për nevojën e hartimit dhe zbatimit të strategjive për rritjen e biznesit	Slide	20 min
<b>2.3. Menaxhimi dhe drejtimi i qendrueshëm</b>	<u>Metoda e 'perceptimit'</u> :Prezanti mi me gojë i perspektivave për ndërtimin e një procesi demokratik vendimarrës	Të kuptojnë hapat që mërren për realizmin e venimarrjes demokratike në një biznes	Slide	45min
<b>2.4 Strategjitë e dhomës së gjelbër: të fitosh me median</b>	<u>Metoda e 'perceptimit'</u> :Prezanti mi me gojë i strategjive për komunikimin me median	Të kuptojnë ndërtimin e strategjive funksionale me median	Slide	25 min
<b>2.5 Planifikoni një strategji të qendrueshme</b>	<u>Metoda e 'perceptimit'</u> :Prezanti mi me gojë i rrugëve për krijimin e një	Të kuptojnë si ndërtohet një reklamë efektive	Slide	20 min

## Doracaku për trajnerët

	marke			
<b>2.6 Marketingu</b> - Krijoni brendin tuaj dhe reklamoheni atë; - Teknologjia; - Marketingu tradicional; - Marketingu online - Promovo pa shpenzuar shumë	<u>Metoda e ‘perceptimit’:</u> Prezantimi me gojë i pikave të përbashkëta dhe të veçanta të marketingut tradicional dhe online	Të kuptojnë se marketing është vlerë dhe jo shpenzim	Slide	32 min
<b>3. Përmbledhje</b>	<u>Metoda e ‘të bërit të vetëdijshëm’:</u> Prezantohet një film i shkurtër	Studentët shikojnë filmin	Filmi dhe multimedia	3min
<b>4. Diskutime &amp; Reagime</b>	Mësuesi u kërkon nxënësve të ngrejnë një fushatë marketing dhe ta prezantojnë atë.	Studentët prezantojnë fushatën e tyre të marketingut	Diskutim	10 min